



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____.2023

VENDIM

Nr. 531, datë 12.10.2023

PËR

**SKUALIFIKIMIN E KANDIDATIT Z. {...},
PËR NË FORMIMIN FILLESTAR NË SHKOLLËN E MAGJISTRATURËS,
PËR MAGJISTRAT, PROFILI GJYQATAR, PËR VITIN AKADEMIK 2021-2022**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 12.10.2023, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, të kandidatit z. {...}”, përgatitur nga relatori z. Alban Toro, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për kualifikimin e kandidatit z. {...} për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, profili gjyqtar, për vitin akademik 2021-2022,

VËREN

I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. Z. {...} është kandidat për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, profili gjyqtar, në kushtet kur:

a) është vlerësuar nga Shkolla e Magjistraturës, në bazë të Raportit të Vlerësimit Përfundimtar të datës 15.04.2021, se plotëson kriteret e pranimit në formimin fillestar për magjistrat sipas nenit 28 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (më poshtë referuar si Ligji për Statusin);

b) ka marrë pjesë në provimin e organizuar nga Shkolla e Magjistraturës sipas nenit 31 të Ligjit të Statusit dhe është përfshirë në listën e renditjes së kandidatëve fitues në formimin fillestar për magjistrat, profili gjyqtar, të miratuar me Vendimin nr. 17, datë 14.05.2021, të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, përcjellë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me Shkresën nr. 365/1 prot., datë 14.05.2021 (protokolluar në Këshill me aktin nr. {...} prot., datë 14.05.2021).

2. Me Vendimin nr. 218, datë 26.05.2021, mbështetur në nenin 32 të Ligjit për Statusin, si dhe në Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” (më poshtë referuar si Vendimi 75/2019), Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur *fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për në formimin fillestar për magistratë, profili gjyqtar, në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2021-2022*, duke caktuar relatorin për çdo procedurë verifikimi për secilin kandidat, ku në bazë të shortit, për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit *për kandidatin z. {...} si relator u caktua z. Alban Toro*.

3. Më datë 26.05.2021, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit {...}2019, kandidati, z. {...}, në rrugë elektronike, u njoftua: - për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit; - për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; - për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtari tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi. Po ashtu, kandidati u njoftua edhe për detyrimin për plotësimin e formularit deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj tij, formular ky që i është bashkëngjitur njoftimit.

4. Brenda afatit treditor, kandidati, z. {...}, depozitoi rregullisht të plotësuar formularin deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj tij. Nga ana tjetër, në këtë afat, kandidati nuk parashtroi ndonjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj tij apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

5. Më datë 01.06.2021, bazuar në pikën 8, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, kandidatit, z. {...}, në rrugë elektronike, iu dërguan formularët dhe autorizimet përkatëse (të përcaktuara në pikën 6, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019) që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej tij në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit.

6. Brenda afatit pesëditor, kandidati, z. {...}, depozitoi formularët dhe autorizimet përkatëse, ndërsa brenda afatit 21 ditor (sipas pikës 4, Seksioni A, Kreu IX, të Vendimit 75/2019), ajo dorëzoi rregullisht edhe formularin “Deklaratë e pasurisë dhe interesave privatë e kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë” pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (më poshtë referuar si ILDKPKI).

7. Në vijim të procedurës së verifikimit, në datën 07.06.2021, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, u kërkuar informacion dhe raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, përcaktuar në nenin 32 të Ligjit të Statusit, për kandidatët për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, ndër ta edhe për z. {...}.

8. Institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, kanë përcjellë për Këshillin e Lartë Gjyqësor informacionet dhe raportimet e tyre në kohë të ndryshme (siç do të përshkruhet më poshtë).

9. Gjatë procedurës së verifikimit, mbështetur në të dhënat e deklaruara nga vetë kandidati në jetëshkrimin e depozituar në rastin e aplikimit pranë Shkollës së Magjistraturës, në lidhje me eksperiencën e tij në punë (punësimin), si dhe në ato të marra nga organet e sigurimeve shoqërore (me Shkresën nr. {...}prot., datë 14.06.2021, të Institutit të Sigurimeve Shoqërore), bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, u kërkua informacion nga subjektet që kanë mbikëqyrur disiplinën në punë të kandidatit z. {...}, të cilët kanë përcjellë për Këshillin e Lartë Gjyqësor informacionet e tyre në kohë të ndryshme (siç do të përshkruhet më poshtë).

10. Pas administrimit të dokumentacionit të nevojshëm, duke çmuar se procedura e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për kandidatin {...}, ishte e plotë dhe në përputhje me kërkesat e Vendimit 75/2019, më datë 25.02.2022, relatori e parashtrori çështjen përpara Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

11. Komisioni i Zhvillimit të Karrierës e shqyrtoi çështjen më datë 25.02.2022 dhe, pasi vlerësoi të plotë procedurën e verifikimit në këtë rast, bazuar në pikën 3, Seksioni C, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, vendosi kalimin e saj për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur ky i fundit për kualifikimin ose skualifikimin e kandidatit {...} për në formimin fillestar për magjistrat (profili gjyqtar) në Shkollën e Magjistraturës.

II. REZULTATET E VERIFIKIMIT PËR KRITERET E PRANIMIT NË FORMIMIN FILLESTAR TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS

A. Për kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për pranimin në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat

12. Sa i përket kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta për pranimin në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, përfshirë edhe për kandidatin {...}, si dhe më lart u parashtrua, vlerësimi për plotësimin e tyre është bërë, në momentin e kandidimit, nga ana e Shkollës së Magjistraturës, bazuar kjo në nenin 30¹ (“Kandidimi dhe vlerësimi paraprak i

¹ “1. Shkolla e Magjistraturës pranon aplikimet për pranimin në formimin fillestar, deri në fund të muajit shkurt të çdo viti. 2. Kandidatët paraqesin dokumentacionin e nevojshëm që vërteton përmbushjen e kriterëve të parashikuara në nenin 28 të këtij ligji. Nëse dokumentacioni i paraqitur nuk vërteton plotësisht përmbushjen e kriterëve, nuk është i plotë, i saktë, ose ka dyshime të arsyeshme për vërtetësinë e tij, Shkolla e Magjistraturës mund të kërkojë informacion ose dokumentacion shtesë nga organet publike ose punëdhënësit e kandidatit. 3. Deri në datën 15 mars të çdo viti, Shkolla e Magjistraturës kryen një vlerësim paraprak, nëse kandidati përmbush kriteret e kandidimit, të parashikuara

kandidatëve”) të Ligjit të Statusit. Në përfundim të vlerësimit, Shkolla ka përgatitur dhe i ka paraqitur Këshillit të Lartë Gjyqësor raportin për rezultatet e vlerësimit paraprak së bashku me dosjet me dokumentet e kandidimit për secilin kandidat, ku pas komenteve të Këshillit, më datë 15.04.2021, Shkolla ka miratuar dhe publikuar në faqen e saj zyrtare Raportin e Vlerësimit Përfundimtar, përfshirë dhe listën e kandidatëve, të cilët plotësonin kriteret e parashikuara në nenin 28 të Ligjit të Statusit. Në këtë listë është përfshirë dhe kandidati {...}.

13. Gjithsesi, për kandidatin {...}, u konsiderua verifikimi sërish i disa prej kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta për pranimin në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, përcaktuar në nenin 28 të Ligjit të Statusit.

13.1 Për këtë u mbajt në konsideratë diferenca kohore mes momentit të aplikimit të kandidatëve (Shkurt 2021), momentit të vlerësimit përfundimtar nga Shkolla e Magjistraturës për plotësimin e kriterëve nga ana e tyre (Prill 2021), si dhe momentit aktual, kur Këshilli duhet të shprehet për kualifikimin ose jo të kandidatëve për në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës, të cilët kanë rezultuar fitues në provimin e pranimit (Shtator 2021). Dhe po ashtu, nga ana tjetër, u mbajt në konsideratë dhe fakti se shumica e kriterëve të pranimit në formimin fillestar janë potencialisht të ndryshueshëm në kohë (me përjashtim të kriterit arsimor, kriterit të përvojës profesionale, kriterit të anëtarësisë në parti politike, në kohën e kandidimit dhe kriterit të anëtarësisë, bashkëpunëtorit ose të favorizuarit nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990).

13.2 Gjithashtu, për këtë u mbajt në konsideratë se një verifikim i tillë është detyrim ligjor për Këshillin e Lartë Gjyqësor që buron nga neni 32 (“Verifikimi i pasurisë dhe figurës”), pika 4/1², shkronja “ç”, të Ligjit të Statusit, sipas të cilit Këshilli ka detyrimin të verifikojë ekzistencën e çdo shkakut përjashtues (të parashikuar nga ligji) nga kandidimi për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës. Përveç kësaj, u mbajt në konsideratë detyrimi i Këshillit për verifikimin e kriterëve të zgjedhshmërisë, të cilat janë njëherazi edhe kriteret e pranimit në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, pra ato sipas nenit 28 të Ligjit të Statusit, është një detyrim konstant i Këshillit qoftë në momentin e emërimit të diplomuarve për magjistrat (profili gjyqtar) në Shkollën e Magjistraturës, ashtu edhe gjatë karrierës së tyre si magjistrat (gjyqtar), referuar për këtë në nenet 35, 64 dhe 66 të Ligjit të Statusit.

në nenin 28 të këtij ligji. 4. Shkolla e Magjistraturës i paraqet Këshillave raportin për rezultatet e vlerësimit paraprak së bashku me dosjet me dokumentet e kandidimit për secilin kandidat. Këshillat mund të japin komente ose kundërshtime jo më vonë se në fund të muajit mars të çdo viti. Shkolla e Magjistraturës miraton raportin e vlerësimit përfundimtar, duke marrë në konsideratë komentet dhe kundërshtimet e bëra, dhe publikon raportin e vlerësimit përfundimtar në faqen e saj zyrtare, duke përfshirë listën e kandidatëve, të cilët plotësojnë kriteret e parashikuara në nenin 28 të këtij. 5. Çdo kandidat, i cili nuk është përfshirë në listën e kandidatëve, të cilët plotësojnë kriteret, ka të drejtë të ushtrojë mjetet ligjore të ankimit, të parashikuara në ligjin "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" dhe aktet nënligjore përkatëse".

² “4/1. Këshillat vendosin që kandidati nuk kalon procesin e verifikimit të pasurisë dhe figurës kur: ...; ç) ka ndonjë shkak tjetër përjashtues të njohur, të parashikuar sipas ligjit”.

14. Konkretisht, për kandidatin u verifikua:

a) *zotësia e plotë për të vepruar*. Për kandidatin nuk u gjet ndonjë e dhënë për heqjen apo kufizimin e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë;

b) *shtetësisë shqiptare*. Në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, kandidati ka depozituar dokumentin “pasaportë biometrike”, lëshuar nga Ministria e Brendshme më datë 13.10.2016, në të cilin përbërësi i gjendjes civile “shtetësia”, pasqyrohet “shqiptare”, ndërkohë që gjatë verifikimit për kandidatin nuk u gjet ndonjë e dhënë për heqjen e shtetësisë shqiptare. Gjithashtu, nga verifikimi i bërë, më datë 23.06.2021, në regjistrin kombëtar elektronik të gjendjes civile të administruar nga Ministria e Brendshme (Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile), sipas certifikatës personale elektronike të printuar në letër nga nëpunësi i ngarkuar i Këshillit, konstatohet se kandidati vijon të ketë shtetësinë shqiptare;

c) *gjendja gjyqësore*. Në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, kjo e fundit ka kryer verifikim në regjistrin elektronik gjyqësor të administruar nga Ministria e Drejtësisë (Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve) duke printuar në letër Certifikatë Elektronike datë 23.02.2021, ndërkohë që gjatë verifikimit, në kuadër të verifikimit të figurës së kandidatit, u administruan Shkresa nr. {...}prot., datë 17.06.2021, e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (Sektori i Gjendjes Gjyqësore). Sipas këtyre dokumenteve, kandidati nuk ka shënime në sistem;

ç) *disiplina në punë*. Në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës kandidati ka depozituar dokumentin “Vërtetim nga ISSH” lëshuar me datë 21.02.2021, ndërkohë që gjatë verifikimit u administruan Shkresa me nr. {...}prot., datë 15.06.2021, e Dhomës Kombëtare të Avokatisë, Tiranë. Sipas dokumentit kandidati nuk është e larguar nga puna për shkaqe disiplinore apo ai nuk ka masë disiplinore në fuqi;

d) *mosqenia bashkëpunëtore, informatore, ose agjente e shërbimeve sekrete*. Në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, kandidati ka depozituar një deklaratë më datë 22.02.2021 në të cilën deklaroi se nuk ka qenë bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete, ndërkohë që gjatë verifikimit nuk u gjet ndonjë e dhënë për qenien e kandidatit bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete.

15. Për kriteret e tjera të pranimit në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës u konsiderua vlerësimi i bërë nga kjo e fundit dhe konkretisht për:

a) *pasjen e kriterit arsimor*. Në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, kandidati ka depozituar dokumentet: “Diplomë – Bachelor në Drejtësi”, me nr. {...}datë 25.10.2011, lëshuar nga Fakulteti i Drejtësisë Universiteti i Tiranës si dhe Certifikatë Notash datë

03.02.2021; “Diplomë –Master i Shkencave në e Drejte Civile ”, me nr. {...} datë 03.04.2014, lëshuar nga Fakulteti i Drejtësisë Universiteti i Tiranës, si dhe Certifikatë Notash datë 03.02.2021;

b) pasjen e përvojës profesionale. Në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës kandidati ka depozituar dokumentin “Vërtetim nga ISSH”, sipas të cilit kandidati, pas përfundimit të studimeve në një program të ciklit të dytë të studimeve universitare në drejtësi, ka përvojë profesionale aktive në sektorin privat me kohë të plotë, në profesionin “Avokat”, person fizik, për periudhën shkurt 2015 – e në vijim ;

c) mos anëtarësinë në parti politike në kohën e kandidimit. Në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, kandidati ka depozituar një deklaratë në datë 22.02.2021 në të cilën deklaroi se nuk është anëtar i ndonjë partie politike;

ç) mosqenien anëtare, bashkëpunëtores ose e favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990. Në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, kandidati ka depozituar një deklaratë në datë 22.02.2021 në të cilën deklaroi se nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990, përveç se referuar moshës së tij (e datëlindjes 07.11.1989), ai nuk mund të ketë qenë i tillë.

B. Për kriterin e pasurisë

16. Për kandidatin {...} u verifikua kriteri i pasurisë, përcaktuar në pikën 1, të nenit 32, të Ligjit të Statusit, sipas të cilës: “1. Kandidatët me rezultatet më të larta në listën e publikuar, sipas përcaktimeve të nenit 31, të këtij ligji, të cilët mund të pranohen në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës, i nënshtrohen verifikimit të plotë të pasurisë ...”.

17. Për verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidatin {...}, u kërkua raportim nga institucionet publike kompetente të përcaktuara në pikën 2, të nenit 32, të Ligjit të Statusit. Ky raportim u kërkua vetëm për kandidatin, në kushtet kur ai nuk ka “person të lidhur” në kuptim të Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar (nenet 3 dhe 5), si dhe Ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar (neni 2).

18. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidatin {...}, u kërkua raportim nga ILDKPKI-ja, e cila ka dërguar në Këshillin e Lartë Gjyqësor Raportin nr. {...} prot., datë 17.09.2021.

18.1 Sipas këtij Raporti të ILDKPKI-së, kandidati {...} ka plotësuar dhe depozituar në afatin e caktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor formularin e deklaratës së pasurisë dhe interesave privatë, si dhe autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë.

18.2 Po ashtu, sipas këtij Raporti të ILDKPKI-së, nga kjo e fundit është kryer kontrolli i plotë për pasuritë, asetet dhe interesat privatë të deklaruara nga kandidati {...}, duke konkluduar se për kandidatin:

- a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;
- c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- d) nuk ka kryer deklaram të rremë;
- e) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

18.3 Referuar rezultateve të kontrollit të plotë për pasuritë, asetet dhe interesat privatë dërguar nga ILDKPKI për kandidatin z. {...}, Relatori, më datë 06.12.2021 me anë të komunikimit elektronik ka parashtruar disa pyetje si vijon, *“Në deklaratimet tuaja të depozituara pranë Inspektoriatit të Lartë të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave nga ana juaj është konfirmuar se pjesë të pasurive të luajtshme të disponuar nga ana juaj, janë dhuratë të babait tuaj.*

Ndërkohë në aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të pasurisë me nr. {...}. prot., datë 02.02.2018 të Inspektoriatit të Lartë të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave për subjektin {...}, rezulton se pas analizës financiare të pasurive të krijuara nga prindërit nga viti 2003 deri në vitin 2016 është konkluduar ndër të tjera se: “deklarimet nuk janë të sakta në përputhje me ligjin; ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar burimin financiar të pasurive. Për sa me lart, lutem na dërgoni opinionin tuaj ligjor në lidhje me përfundimet e kontrollit të sipërcituar dhe ndikimet e tij në analizën e pasurisë që ju dispononi.....”.

18.3.1 Në përgjigje të këtyre pyetjeve z. {...} më datë 10.12.2021 me anë të komunikimit elektronik ka parashtruar sqarime si vijon: *“Në lidhje me këtë rrethanë më është kërkuar që të jap opinionin tim ligjor në lidhje me përfundimet e kontrollit të sipërcituar dhe ndikimet e tij në analizën e pasurisë që unë disponoj. Bazuar në atë çka Ju më keni kërkuar, çmoj që të jap sqarimet e mia në lidhje me kontekstin dhe arsyet për të cilat është bërë dhurimi i 50% të pjesës takuese të dy automjeteve që janë në pronësi të babait tim Z. {...}. Konkretisht, në vitin 2006, babai im ka blerë automjetin e markës VW Golf III, me targa {...} prodhim i vitit 1995. Fillimisht ai ka qenë pronari i vetëm i këtij automjeti, duke qenë se ishte personi i vetëm në familje i cili ishte i pajisur me leje drejtimi. Theksoj, se në kohën e blerjes së këtij automjeti unë kam qenë i mitur, në moshën 16 vjeçare. Në vitin 2010, babai im ka blerë një automjet të dytë, të markës Mercedes Benz C220 prodhim i vitit 2002, ku përsëri ai ka qenë pronar i vetëm i këtij automjeti. Në këtë periudhë, unë kam qenë madhor, ku ndiqja studimet pranë Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës. Në fillim të vitit 2010, e konkretisht më datë 04.02.20210, unë jam pajisur me leje drejtimi të klasit B. Ky moment ka shënuar edhe periudhën që unë kam nisur të përdor automjetet që ishin në pronësi*

të familjes sime, e konkretisht të babait tim Z. {...}. Kuptohet që përdorimi i automjeteve ka qenë në raste sporadike, për nevojat e lëvizjes së familjareve të mi, konkretisht të nënës apo dy motrave, sipas rastit. Në bazë të ligjit të kohës, e konkretisht normave të Kodit Rrugor, ishte e detyrueshme që personi i cili përdorte një automjet, të ishte pronar i tij ose i autorizuar nëpërmjet një akti noterial nga ky i fundit. Në të kundërt, nëse dikush do konstatohej se drejtonte një automjet i cili nuk ishte në pronësi të tij ose nuk ishte i autorizuar nga pronari i automjetit për përdorimin e tij, ndëshkoheshe me masë administrative nga Organit Administrativ Shtetëror. Duke qenë përpara një parashikimi ligjor si më lart, nga ana e babait tim është menduar që të më dhurojë 50% të pronësisë mbi automjetin, në mënyrë që të mos has pengesë nga autoritetet policore në rast kontrolli. Kalimi i pronësisë është bërë me akt noterial, në formën e kontratës së dhurimit, të cilat janë në një periudhe të afërt kohore. Konkretisht kalimi i 50% të automjetit Mercedes Benz me targe është bërë nëpërmjet kontratës së dhurimit nr. {...} rep., nr. {...} kol. të datës 19.07.2011. Në të njëjtën logjikë dhe për të njëjtat arsye që përshkrova më lart, me kontratën e dhurimit nr. {...} rep., nr. {...} kol., është bërë dhe kalimi i 50% të pjesës takuese të automjetit VW Golf III, me targë , prodhim i vitit 1995 Pas përpilimit të kontratave, ato janë regjistruar pranë drejtorisë së shërbimit të transportit rrugor përkatës, të cilat kanë reflektuar ndryshimet, duke na pajisur me leje qarkullimi të cilat figurojnë në emrin e babait dhe në emrin tim. Me kalimin e viteve parashikimet ligjore kanë ndryshuar, ndryshe nga sot, ku lejohet përdorimi i një automjeti edhe nëse nuk je pronar i tij. Dua të theksoj se pavarësisht se kalimi i pronësisë është bërë në formën e kontratës së dhurimit, synimi i tyre ka qenë qarkullimi dhe lëvizja në përputhje me parashikimet ligjore dhe jo krijimi i drejtave të pronësisë mbi këto automjete. Mbi këto dy automjete, unë nuk kam asnjë pretendim dhe është në vullnetin e lirë të prindërve të mi disponimi i tyre. E drejta ime mbi këto automjete, ka qenë dhe është gjithmonë në kufijtë e përdorimit për nevojat e mia apo të familjarëve të mi, siç është në çdo familje besoj, për shkak të lidhjeve shpirtërore. Duke qenë në rrethanat e mësipërme, theksoj edhe një herë se pasuritë e luajtshme në të cilat unë paraqitem si pronar në masën 50%, janë bërë për shkaqe të diktuara nga parashikimet ligjore, për të qenë në përputhje me ligjin. Automjetet që unë kam disponuar gjithmonë janë blerë me të ardhurat e familjes sime, por për rrethana objektive, janë regjistruar në emrin tim. Një sjellje të tillë e konsideroj normale brenda një familje dhe nuk mendoj se duhet të ketë pasoja mbi personin tim në lidhje me procesin të cilit po i nënshtrohem. Gjithashtu, çmoj me rëndësi që t'ju theksoj se nga ana e I.L.D.K.P.K.I në asnjë moment nuk është pretenduar se të ardhurat e familjes sime nuk justifikojnë blerjen e ndonjë prej automjeteve. Duke Ju falenderuar për komunikimin tuaj, shpresoj që përgjigjja ime të ketë qenë ezauruese në atë çfarë Ju më keni kërkuar. Përtej kësaj unë mbetem i hapur për të dhënë sqarim për çdo çështje që Ju e konsideroni me rëndësi për procesin që po kryhet.....”.

19. Në kushtet kur pasuritë e disponuara si edhe një pjesë e të ardhurat për jetesë të kandidatit, e kanë origjinën tek kontributi i prindërve të tij u administrua edhe një kopje e Vendimit nr.478, datë 25.11.2021 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit në të cilën është vendosur “Shkarkimi nga detyra e subjektit të rivlerësimit {...}, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësorë Mat.....”. Në këtë vendim nga ana e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit ndër të tjera është konstatuar se subjekti i

rivlerësimit “..... ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe kryerjen e shpenzimeve për periudhën 2003-2016; Ka bërë deklarime të pasaktë lidhur me pasuritë e krijuara dhe burimin e ligjshëm; Ka bërë deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, në kuptim të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr.84/2016.....”.

20. Për verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidatin {...} u kërkua informacion Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

20.1 Nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve informacioni u dërgua me Shkresën nr. {...}prot., datë 25.06.2021, me Shkresën nr. 14521/1 prot., datë 16.08.2021 dhe me Shkresën nr. 2539/1 prot., datë 26.08.2021, ku për kandidatin {...}, subjekt tatim pagues me status person fizik (Avokat) pranë Drejtorisë Rajonale Dibër që prej periudhës shkurt 2015 e në vijim. Sipas informacionet të përcjell nga Drejtorisë Rajonale Dibër subjekti i vlerësimit z. {...} nuk ka detyrime tatimeve, nuk ka shpërndarje dividendi si dhe të ardhura të deklaruara nga burimet te tjera nuk ka.

20.2 Nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave informacioni u dërgua me Shkresën nr. 10356/1 prot., datë 30.06.2021, ku për kandidatin {...} nuk jepet ndonjë e dhënë me karakter pasuror.

21. Të dhënat e dërguara përmes informacioneve respektive nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, por edhe institucionet e tjera të përcaktuara në pikën 2, të nenit 32, të Ligjit të Statusit, u ballafaquan me të dhënat sipas Raportit të ILDKPKI-së, duke u vlerësuar se nuk kishte vend për t’iu kërkuar kësaj të fundit bërja e një kontrolli dhe raportimi shtesë.

22. Nga verifikimi i kriterit të pasurisë për kandidatin {...} janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet se për të nuk ekziston asnjë prej shkaqeve të skualifikimit nga formimi fillestar për në Shkollën e Magjistraturës sa i përket kriterit të pasurisë, patur parasysh për këtë përcaktimin e shkronjës “a”, pika 4/1, të nenit 32, të Ligjit për Statusin, sipas të cilit: “4/1. Këshillat vendosin që kandidati nuk kalon procesin e verifikimit të pasurisë ... kur: a) burimet financiare të kandidatit nuk justifikojnë pasuritë e tij dhe nuk ka deklaruar pasuri ose asete duke i fshehur ato, ose në mënyrë të qëllimshme ka dhënë një deklaratë të rreme ose jo të saktë të aseteve, ose kandidati gjendet në situatën e konfliktit të interesit; ...”. Konkretisht, për kandidaten verifikohet që:

- a) kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht formularin e deklaratës së pasurisë;
- b) kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht, të nënshkruara, autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë;
- c) kandidati ka burime financiare për të justifikuar pasuritë e tij;

- ç) deklarimi nga kandidati i pasurisë, aseteve ose të interesave private, të detyrueshme për t'u deklaruar, është i plotë, i vërtetë dhe i saktë.

23. Të dhënat e rezultuara si më sipër nga procesi i verifikimit të pasurisë nuk iu nënshtruan vlerësimit të Këshillit, pasi prej këtij të fundit, pas komunikimit të gjetjeve kandidatit lidhur me figurën sikundër do të arsyetohet në vijim, u vlerësua se, bazuar në rezultatin tërësor të hetimit administrativ, mosplotësimi në rastin konkret vetëm i kriterit të figurës, passillte skualifikimin e kandidatit.

24. Bazuar në aktet që janë depozituar në dosjen e kandidatit, Këshilli vlerëson se kriteret e kandidimit për magjistrat të përcaktuara nga dispozitat kushtetuese dhe ato ligjore të nxjerra në pajtim me të, duhet të plotësohen secila dhe të gjitha së bashku, në mënyrë që kandidati të vijojë procedurën e pranimit në programin e formimi fillestar për në Shkollën e Magjistraturës parashikuar nga neni 28 dhe 32 e vijues i Ligjit të sipërcituar. Mos plotësimi i vetëm njërit prej tyre shkakton skualifikimin e kandidatit. **Në rastin konkret mosplotësimi i kriterit të figurës shkakton skualifikimin e kandidatit, pa qenë e nevojshme vlerësimi i njëkohshëm i kriterit të pasurisë. Në këto kushte nga ana e Këshillit u procedua me vlerësimin e figurës së kandidatit, kriter ligjor shumë i rëndësishëm për vijimin e kandidimit.**

C. Për kriterin e figurës

25. Për kandidatin {...} u verifikua kriteri i figurës, përcaktuar në pikën 1, të nenit 32, të Ligjit të Statusit, sipas të cilës: *“1. Kandidatët me rezultatet më të larta në listën e publikuar, sipas përcaktimeve të nenit 31, të këtij ligji, të cilët mund të pranohen në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës, i nënshtrohen verifikimit të plotë të ... figurës”.*

26. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të figurës për kandidatin {...}, u kërkua raportim nga institucionet ligjzbatuese të përcaktuara në pikën 2, të nenit 32, të Ligjit të Statusit.

27. Po ashtu, për verifikimin e kriterit të figurës për kandidatin {...}, atij iu kërkua dhe plotësoi e depozitoi rregullisht pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, më datë 02.06.2021, formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe autorizimin për Këshillin që, në zbatim të pikës 2 të nenit 32 të Ligjit për Statusin, të kryejë verifikimin në organet kompetente sipas ligjit, të dhënave të tij në lidhje me figurën dhe integritetin.

28. Po në kuadër të zbatimit të Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, mbi kërkesë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Gjendjes Civile, me Shkresën nr. {...}1 prot., datë 09.07.2021, protokolluar në Këshill me aktin nr. {...}1 datë 12.07.2021, ka dërguar të dhënat për

përbërësit e gjendjes civile edhe për kandidatin {...} pas verifikimeve të bëra në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010 dhe në zyrat përkatëse të gjendjes civile.

29. Bazuar në informacionin e dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve (Sektori i Gjendjes Gjyqësore) sipas shkronjës “c”, pika 14, e këtij vendimi, si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Gjendjes Civile, nëpunësi përgjegjës i strukturës së posaçme pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi kreu verifikimet e rastit, nuk konstatoi mangësi në të dhënat e deklaruara nga kandidati {...} në formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, duke konkluduar se kandidati: - *ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit më datë 02.06.2021*; - *formulari është regjistruar me numrin unik 000558*; - *vetëdeklarimi është bërë publik, në faqen zyrtare web të KLGJ-së*; - *në formular, nuk ka të deklaruar të dhëna që përfshihen brenda sferës së ndalimeve të parashikuar me ligj*; - *nuk ka deklaruar gjeneralitete të mëparshëm*; - *nga përgjigjet e ardhura nga zyra e gjendjes gjyqësore dhe zyra e gjendjes civile, nuk kanë rezultuar ndryshime të dhënave të gjendjes civile apo gjendjes gjyqësore, nga ato të deklaruara*; - *deri më sot nuk kemi pasur indicie apo të dhëna kryesisht, për të kërkuar verifikim të thelluar nga Prokuroria e Përgjithshme.*

30. Po ashtu, për verifikimin e kriterit të figurës për kandidatin {...}, mbi kërkesën e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Prokuroria e Përgjithshme ka kryer verifikimin përkatës në të gjitha prokuroritë që ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë, duke përcjellë në Këshill, me Shkresën nr. 924/25 prot., datë 08.09.2021, protokolluar me aktin nr. 2674/1, datë 08.09.2021, përgjigjet zyrtare të 22 (njëzet e dy) prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë. Gjithashtu, u administrua dhe përgjigja e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, përcjellë në Këshill, me Shkresën nr. {...} prot., datë 03.09.2021, protokolluar me aktin nr. {...}, datë 07.09.2021. Referuar përmbajtjes së këtyre përgjigjeve rezultoi se për kandidatin {...}, nuk është regjistruar kallëzim/referim/procedim penal, nuk ka qenë ose është në hetim, nuk është caktuar ndonjë masë sigurimi, nuk është dënuar me vendim jopërfundimtar apo të formës së prerë për kryerjen e ndonjë vepre penale. Në këtë kontekst u administruan edhe aktet, bashkëlidhur **Vendimit nr. {...}, datë 05.06.2019 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda. Ky akt dhe çdo dokument tjetër, përveç dokumentacionit të përfituar nga organet ligjzbatuese, aktet e të cilëve mbrohen nga Ligji nr.8457, datë 11.02.1999 “Për Informacionin e Klasifikuar Sekret Shtetëror” i është vënë në dispozicion kandidati kundrejt kërkesës së tij.**

III. SHQYRTIMI NGA KËSHILLI I REZULTATEVE TË VERIFIKIMIT TË FIGURËS

31. Nga verifikimi i kriterit të figurës për kandidatin {...} janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat konkludohet se për të ekzistojnë shkaqe të qenësishme për ta skualifikuar dhe për të ndaluar procedurën e mëtejshme të verifikimit me qëllim pranimin në formimin fillestar për në Shkollën e Magjistraturës sa i përket kriterit të figurës, duke pasur parasysh përcaktimet e shkronjës “c”, pika 4/1, të nenit 32, të Ligjit për Statusin, sipas së cilës: “4/1. *Këshillat vendosin*

që kandidati nuk kalon procesin e verifikimit të .. figurës kur: ...; b) kandidati ka lidhje ose kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar; c) ka shfaqur sjellje të rënda të papërshtatshme etike dhe morale që cenojnë besimin e publikut në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë; ka ndonjë shkak tjetër përjashtues të njohur, të parashikuar sipas ligjit.....”. Ky verifikim përbën standardin kushtetues dhe ligjor tashme të sanksionuar edhe nga ligji për figurën dhe integritetin jo vetëm të gjyqtarëve që ushtrojnë funksionin por edhe të kandidatëve që do të bëhen pjesë e trupës gjyqësore në të ardhmen.

32. Këshilli i Lartë Gjyqësor për shkak të funksionit që kryen, përmbush të gjitha garancitë kushtetuese konform standardeve të pranura ndërkombëtarisht për t’u kualifikuar si një organ publik që ushtron funksione “*quasi-gjyqësore*” në drejtim të veprimtarisë së tij në kuadër të vlerësimit të kriterëve për emërimin e gjyqtarëve, duke qenë në sensin substancial “*gjykatë e krijuar me ligj*” në kuptim të nenit 6 të KEDNJ. Vlerësimi i kriterëve ligjore për emërimin e gjyqtarëve, është pjesë e një procedure administrative, e cila vepron si parakusht i domosdoshëm në procesin e emërimit dhe, si e tillë, kjo procedurë duhet të garantohet përmes procesit të rregullt ligjor. Për shkak të këtij strukturimi kushtetues që i është bërë KLGJ-së, ky organ gëzon autoritetin kushtetues dhe ligjor për të vepruar si “*shkallë e parë gjykimi*”, lidhur me çështjen e përmbushjes së kushteve dhe kriterëve për emërimin e gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë. Në procesin e verifikimit të kriterëve për emërimin e gjyqtarëve, Këshilli, njëlloj si gjykata, ka detyrimin të zhvillojë një proces të rregullt ligjor, nëpërmjet garantimit të një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm. I gjithë procesi administrativ që bën Këshilli është një verifikim nga e para që Këshilli i bën ndër të tjerash edhe figurës së kandidatit, duke pasur autoritetin ekskluziv të dhënë nga ligji për të vendosur përfundimisht lidhur me këtë çështje. Gjatë veprimtarisë së tij ligjore, organi administrativ shpreh vullnetin nëpërmjet akteve administrative individuale, të cilat rregullohen për nga forma dhe procedura e nxjerrjes prej Kodit të Procedurave Administrative dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi. Veprimtaria administrative e këtij organi konkretizohet me hartimin dhe nxjerrjen e këtyre akteve, të cilat janë shfaqje të vullnetit të tij, në përputhje me legjislacionin në fuqi, si dhe kanë për qëllim, krijimin, ndryshimin, apo shuarjen e pasojave të caktuara juridike. Këto akte për nga forma apo përmbajtja e tyre janë akte administrative me karakter të mirëfilltë individual, pasi nxirren në zbatim të një norme të përgjithshme, rregullojnë një çështje të caktuar, i drejtohen një numri të caktuar subjektsh, të cilët kanë kërkuar shprehjen e vullnetit të saj si dhe evidentojnë qartë karakterin shtetës të tyre.

33. Parimet e shtetit të së drejtës të sanksionuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, “E drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit” (neni 4 i Kushtetutës) detyron dhe limiton vullnetin e organit administrativ, në rastin de qua Këshilli i Lartë Gjyqësor, në domosdoshmërinë e respektimit të parimeve thelbësore përgjatë procedurës administrative të zbatuar në respektim të statusit të gjyqtarit, të drejtave të përfshira në të dhe në mënyrë të veçantë të karrierës së tij. Në këtë kuadër karriera, si pjesë integrale e garancive që burojnë nga neni 138 i Kushtetutës (paga dhe përfitimet e tjera), është në funksion të garantimit të pavarësisë së gjyqësorit dhe respektimi i

tyre krijon njëkohësisht besimin te publiku për sa i përket pavarësisë, integritetit dhe paanshmërisë së gjyqtarëve.

34. Shteti i së drejtës, si një nga parimet themelore të një shoqërie demokratike, përmban në vetvete detyrimin e autoriteteve publike për të shprehur vullnetin e tyre në çdo rast kur i kërkohet nga ligji nëpërmjet akteve administrative (neni 16 i Ligjit nr.44/2015 K. Pr. A), të cilat nuk duhet të përbëjnë “flatus vocis” por duhet të përfaqësojnë cilësinë efektive të ushtrimit të aktivitetit administrativ, sjellja e të cilit duhet të jetë legjitime (neni 4 Ligjit nr.44/2015 K. Pr. A), e drejtë dhe e paanshme (neni 13 Ligjit nr.44/2015 K. Pr. A), e hapur dhe bashkëpunuese me personat private (neni 10 Ligjit nr.44/2015 K. Pr. A), deri në masën kur nuk janë parashikuar kufizime ligjore.

35. Aktet juridike që nxirren nga ky organ duhet të jenë në pajtim me aktet juridike më të larta si në kuptimin formal, ashtu edhe atë material. Respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor. Siç rezulton nga arsyetimi i sipërcituar karakteri ligjor i aktit administrativ është një ndër veçoritë kryesore të tij. Sipas këtij elementi të rëndësishëm akti duhet t’i referohet në çdo rast kërkesave të ligjit me qellim që të mos vij në kundërshtim me të dhe të mos kalojë kufijtë e tij. Që akti të jetë i ligjshëm duhet që përmbajtja e tij të jetë e njëjtë me përmbajtjen e vetë ligjit në zbatim të të cilit është nxjerrë si edhe me legjislacionin në terësi. Ligjshmëria e aktit administrativ kërkon detyrimisht nga organi i administratës publike respektimin me përpikëri dhe rigorozitet të elementeve thelbësore, si kompetenca e organit, procedura e ndjekur për nxjerrjen e aktit, respektimi i formës apo i elementeve të detyrueshme të aktit, barazia e armeve, respektimi i ligjit material, dhe në mënyrë të veçantë respektimin e nenit 6 dhe 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, (e drejta për një gjykim të drejtë).

36. Duke iu kthyer analizes se rastit “de qua”, Këshilli i Lartë Gjyqësor, se për shkak të aksesit që ka pasur në informacion të klasifikuar, detyrimi ligjor për të ruajtur konfidencialitetin e tyre e cila në fakt në vështrim të nenit 46 të Ligjit nr.44/2015 Kodi i Procedurës Administrative” në të cilën përcaktohet se “e drejta e palëve, sipas nenit 45, të këtij Kodi, kufizohet vetëm në ato raste dhe në atë masë që parashikohet nga legjislacioni në fuqi” kufizon të gëzimet e të drejtave të kandidatit në lidhje me parimet e gjykimit bazuar në kontradiktoriteti dhe barazinë e armëve, të cilat gjithësesi u balancuan në një mënyrë të tillë që të shmangej arbitrariteti ndaj thelbit të së drejtës për një gjykim të drejtë .

37. Ligji i posaçëm, Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 32 ka përcaktuar procedurë të detajuar si edhe burimet e provës me anë të së cilës kandidatët që konkurrojnë për t’u pranuar e vijuar studimet në formimin fillestar të magistraturës si gjyqtar, do të duhet t’i nënshtrohen kontrollit, ndër të tjera, jo vetëm të pasurisë duke analizuar në lidhje me të vërtetësinë, saktësinë e deklaratimit dhe ligjshmërinë e burimeve të krijimit, pa asnjë dallim dhe kufizim, i artikuluar ky sipas kriterit të kohës së krijimit apo çdo lloj kriteri tjetër përcaktues por edhe vlerësimin etiko moral e profesional të kandidatit si magistrat

(neni 32/4.1 parag c dhe ç). Ky nen jo vetëm mbart garanci për respektimin e interesit publik por ai është përfshirë nga ligjvënësi për shkak të nevojës dhe domosdoshmërisë që mbart integriteti si element thelbësor i funksionit të magjistratit.

38. Për shkak të natyrës së funksionit që kryen në shoqëri, integriteti i magjistratit është më shumë se virtyt, është një domosdoshmëri, sepse besimi i publikut tek institucionet e drejtësisë nuk varet vetëm nga profesionalizimi i tyre, por edhe nga integriteti moral. Magjistrati ose kandidati për magistrat, i cili është subjekt që së shpejti pritet të jetë pjesë e sistemit të drejtësisë duhet që gjithmonë dhe jo vetëm gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare, por kurdoherë të sillet me nder dhe të jetë i virtytshëm që të kontribuojë në rritjen e besimit të qytetarëve tek sistemi, profesionistët e sistemit të drejtësisë dhe të jetë në gjendje që të ofrojnë besueshmëri.

39. Nga hetimi administrativ dhe në bashkëpunim me organet ligjzbatuese konform nenit 32 të Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, u administruan akte zyrtare e të dhëna të kategorizuar nga Ligji nr.8457, datë 11.02.1999 “Për Informacionin e Klasifikuar Sekret Shtetëror” si sekret shtetëror dhe si i tillë i pa aksesueshëm pasi ekspozimi i të cilit do t’i sillte rrezik sigurisë kombëtare. Aktet e sipërcituara në kuptim të nenit 32 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, përbën provë mbi të cilat Këshilli vlerëson etikën, integritetin dhe sjelljet e kandidatit si elemente të figurës së tij. Për shkak të rëndësisë së përmbajtjes së tyre u mundësuan takime të drejtpërdrejta me përfaqësues të organit i cili ka dërguar aktin zyrtar. Nga këto takime rezultoi se figura e të verifikuarit nuk ishte e përshtatshëm me figurën e kandidatit për magistrat, për rrethana që lidhen me integritetin e tij që mund të cenonjë besimin e publikut. Në kuadër të një verifikimi të plotë dhe të gjithanshëm rezultatet e takimit konfirmojnë përmbajtjen e akteve zyrtare të dërguar nga Institucioni ligjzbatues. Në vijim të rrethanave të konstatuara me lart që lidhen me integritetin e kandidatit me qëllim ndryshimin e klasifikimit të statusit të dokumentacionit dhe informacionit të klasifikuar për të njoftuar me pas kandidatit për gjetjet që përmbaheshin në të, Këshilli i Lartë Gjyqësor beri përpjekje për deklasifikimin e tyre. Ky veprim procedural u krye me qëllim vlerësimin e ekuilibrit midis nevojës për të ruajtur informacionin e klasifikuar sekret si edhe të drejtës së kandidatit për akses dhe për t’u njohur me provat, e drejtë e lidhur ngushtësisht me ushtrimin e të drejtave të tij të mbrojtjes, barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit në gjykim. Në vijim të përpjekjes për deklasifikimin, Këshilli krijoi Komisionin e Posaçëm të Deklasifikimit konform Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.662, datë 15.11.2017 ”Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “Sekret Shtetëror”. Komisioni në vijim të veprimtarisë së tij mori në shqyrtim aktet zyrtare dhe rëndësinë që paraqesin përmbajtjet e tyre. Në vlerësim të rëndësisë të përmbajtjes, natyrës së çështjes në proces verifikimi si edhe sensibilitetit që ato krijojnë ne raport me besimin e publikut me Vendimin nr.01, datë 06.10.2022 “Për përjashtimin e informacionit të klasifikuar sekret shtetëror nga deklasifikimi”, Komisioni i Posaçëm, vendosi përjashtimin e akteve nga deklasifikimi për shkak se aksesimi i saj do të cenonte sigurinë kombëtare.

40. Në përputhje me kompetencat që i nje ligji Ligjit për Statusin, Ligji nr.8457, datë 11.02.1999 “Për Informacionin e Klasifikuar Sekret Shtetëror”, Këshilli i Lartë Gjyqësor vijoi bashkëpunimin me organet ligjzbatuese dhe pas analizës juridike të përmbajtjes së dokumentave të klasifikuar konkludoi se kandidati nuk përmbushte kushtet ligjore për t i besuar sekretet. Aksesimi i kandidatit në përmbajtjen e këtyre informacioneve mund të shkaktojë zbulimin e metodave të punës së organeve ligjzbatuese, zbulimin e burimeve të tij të informacionit apo asetëve të tjera që ka ndihmuar në përpilimin e të dhënave duke dëmtuar në tërësinë e tyre sigurinë kombëtare për shkak të sensibilitetit të veçantë të të dhënave. Më tej një kufizim i tillë parashikohet edhe në nenin 17, pika 2, germa “a” të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit” i cili kufizon këtë të drejtë duke respektuar parimin e proporcionalitetit nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë për sigurinë kombëtare.

41. Në këtë kontekst Këshilli ka detyrimin të vlerësojë për çdo rast individual nevojën e ruajtjes së sekretit shtetëror, në raport me domosdoshmërinë për të gjykuar me objektivitet dhe për të nxjerrë të vërtetën gjatë hetimit administrativ, veçanërisht kur kjo sjell pasojën e skualifikimit për kandidatin.

42. Me administrimin dhe detyrimin për ruajtjen e të dhënave “sekrete”, analizimin e saj në mënyrë të pavarur, të paanshme, madje duke kërkuar dhe në përputhje edhe me nenin 71 të Ligjit nr.44, datë 2015 “Kodi i Procedurës Administrative”, ndihmë juridike, me aktorë të tjerë në funksion të krijimit të bindjes së brendshme dhe evitimit të çdo qëndrimi arbitrar ndaj të drejtave të kandidatit, Këshilli krijoi një raport të drejtë dhe të arsyeshëm midis ndërhyrjes së veprimtarisë shtetërore dhe sferës së lirisë së individit duke ruajtur në këtë mënyrë parimin e procesit të rregullt ligjor. Natyrisht ky raport u krijua në funksion të zbatimit edhe të parimit të proporcionalitetit i cili u vlerësua në rastin konkret duke marrë në konsideratë disa aspekte, si: balancën mes së drejtës së kufizuar dhe interesit publik ose mbrojtjes së të drejtave të të tjerëve, mjetin e përdorur në raport me gjendjen që e ka diktuar atë, të drejtën e cenuar dhe synimin që kërkon të arrihet. Këto aspekte u vlerësuan të gërshetuar me njëri-tjetrin.

43. Një jurisprudencë të tillë aktive ka ndjekur Gjykata Kushtetuese, Gjykata e Lartë dhe në mënyrë të veçantë edhe Gjykata e të Drejtave të Njeriut, e cila në shumë vendime të saj ka theksuar se parimi i kontradiktoritetit dhe parimi i barazisë së armëve në gjykim janë standarde thelbësore të të drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 6/1 të KEDNJ por jo në vlerë absolute. *“Palët duhet të gëzojnë “një ekuilibër të drejtë” në procesin gjyqësor. Pala kërkuese duhet të ketë, në mënyrë të arsyeshme, mundësinë për të paraqitur çështjen, në kushte që nuk e vendosin atë në disavantazh thelbësor kundrejt palës kundërshtare (Avotinš k. Letonisë). Megjithatë, këto të drejta nuk kanë karakter absolut. GJEDNJ ka vlerësuar se në kontekstin e të drejtave procedurale civile, parimet e nenit 6/1 të Konventës konsiderohen të përmbushura, kur Autoritet Publike kanë pavarësinë dhe paanshinë e nevojshme, kanë akses të pakufizuar në të gjitha dokumentet e klasifikuara që justifikojnë vendimmarrjen e organit, kur vlerësojnë në thelb vendimmarrjen për revokimin e certifikatës së sigurisë dhe mund të shfuqizojnë vendimmarrjen arbitrare, nëse është e nevojshme (çështja Gulamhussein dhe Tariq k. Mbretërisë së Bashkuar, 2018 paragrafi 71)*

Gjykata ka vlerësuar se të drejtat që rrjedhin nga neni 6/1 i KEDNJ nuk janë absolute. Gjithashtu, e drejta për të zbuluar prova relevante nuk është një e drejtë absolute, megjithatë, vetëm masat kufizuese që nuk cenojnë thelbin e së drejtës janë të lejuara në kuptim të nenit 6/1 të KEDNJ. Vështirësitë që shkaktohen nga kufizimi i të drejtave duhet të jenë të balancuara mjaftueshëm nga procedurat vijuese të autoriteteve gjyqësore (lexo administrative)”.

43.1 Më tej në rastin kundër Republikës Çeke, GJEDNJ pasi kishte konstatuar se kërkuesi nuk i ishishin vënë në dispozicion dokumentet e klasifikuar, në vendimin e saj ka theksuar se: “...Duke pasur parasysh gjykimin në tërësi, natyrën e mosmarrëveshjes dhe marzhin e vlerësimit që gëzojnë autoritetet e brendshme, kufizimet që veprojnë mbi gëzimin e të drejtave nga kërkuesi, të dhëna atij në pajtim me parimet e gjykimit bazuar në parimet e kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve, ishishin balancuar në një mënyrë të tillë që një balancë e drejtë ndërmjet palëve nuk ishte cenuar në mënyrë të tillë që të cenonte thelbin e së drejtës së kërkuesit për një gjykim të drejtë. [...] e drejta për zbulimin e provave përkatëse nuk është një e drejtë absolute..”, ka vlerësuar të drejtë qëndrimin e autoritetit publik i cili nuk kishte mundësuar vënien në dispozicion të provave kërkuesit për arsye të mos cenimit të interesit publik duke mos konstatuar shkelje të neni 6/1 të Konventes.

44. Në vlerësimin tërësor, në kuptim të nenit 32, i Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli në përfundim të analizës të të dhënave të klasifikuara, se për shkak të cenimit të integritetit/figurës nga këto të dhëna krijohet dyshimi i arsyeshëm të çdo qytetar se kandidati, me sjelljen e tij, ka vendosur interesin personal mbi atë të shoqërisë/publikut dhe sundimit të paanshëm të ligjit, duke cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, dhe duke bërë që ai të jetë i papërshtatshëm për t’u integruar në trupën gjyqësore.

45. Në vështrim të nenit 6/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i cili parashikon: “Ndalohet zgjedhja, emërimi apo ushtrimi i një funksioni publik në një nga organet e parashikuara në këtë Kushtetutë, ose të krijuara me ligj, pavarësisht përcaktimeve të bëra në dispozitat e tjera të kësaj Kushtetute, nëse verifikohen rrethana që cenojnë integritetin e funksionarit publik, sipas kushteve dhe rregullave të përcaktuara me ligj të miratuar me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.”, përcaktohet një kufizim esencial i cili synon të garantojë integritetin, i cili është qenësor për veprimtarinë e mirëfilltë të një kandidati për magjistrat, kjo pasi gjyqtari mbart detyrimin të zbatojë dhe gëzojë standarde të larta të integritetit. Integriteti i tij është kriter për të përcaktuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë dhe për rrjedhim kandidati për magjistrat, duhet të ketë cilësi dhe të sillet në atë mënyrë që afirmon besimin e publikut dhe integritetin e sistemit të drejtësisë.

46. Në nenin 32, pika 4/1 të Ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në R.Shqipërisë” në të cilën në mënyrë respektive parashikohet se: “ Këshillat vendosin që kandidati nuk kalon procesin e verifikimit të pasurisë dhe figurës kur :c) **ka shfaqur sjelle të rënda të papërshtatshme etike dhe morale që cenojnë besimin e publikut në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë.**ç) ka ndonjë shkak tjetër përjashtues të njohur, të parashikuar sipas ligjit.”. Bazuar në këtë parashikim ligjor, Këshilli edhe më parë ka vlerësuar se, në kuptim të verifikimit të kriterit

të figurës së kandidatit dhe vlerësimit për pranueshmërinë ose jo të një kandidati për në formimin fillestar për magistrat në Shkollën e Magjistraturës është edhe etika dhe morali në çdo sjellje të evidentuar në të kaluarën e tij, për të cilat Këshilli ka për detyrë të verifikojë dhe vlerësojë nëse ato janë në përputhje me vlerat themelore të një magjistrati, standardet etike dhe rregullat e sjelljes, të përcaktuara këto në nenet 3 dhe 4 të Ligjit të Statusit. Këto sjellje etike dhe morale që të passjellin skualifikimin e kandidatit, duhet të jenë të rënda në atë masë sa të çenojnë besimin e publikut në sistemin gjyqësor.

47. Në përfundim Këshilli i Lartë Gjyqësor në vlerësim dhe analizë të dokumenteve të klasifikuara, hapësirën e vlerësimit të tyre duke pasur në konsideratë procedurat në tërësi, kërkesat ligjore për figurën dhe integritetin e trupës aspirantë për magistrat, krijimin e një ekuilibri e konpesimi të drejtë midis kufizimit ligjor të parimit të kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve, mbrojtjes së veçantë kushtetues që gëzon interesi publik në komponentin e sigurisë kombëtare në një mënyrë të tillë që ka ruajtur balancën mes palëve, pa u cenuar e të drejtën e tij për një gjykim të drejtë (çështja *k. Republikës Çeke 2017*, paragrafi 161), proporcionalitetit dhe diskrecionit të ushtruar nga autoriteti publik, konkludon në ndalimin e kandidatimit të tij për shkak të cenimit të figurës së tij.

IV. KONKLUZIONE

48. Referuar përcaktimeve të Vendimit 75/2019, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për kandidatin z. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se procedura e verifikimit e ndjekur në këtë rast është e plotë dhe në përputhje me ligjin.

49. Bazuar në sa më lart është parashtruar, mbi rezultatet e verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për kandidatin z. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidati **nuk përmbush një nga këto kritere, pikërisht atë të figurës, shkak për të cilin, bazuar në shkronjën “c” dhe “ç”, pika 4, të nenit 32, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, është vendi për skualifikimin / ndalimin e kandidimit të tij për në formimin fillestar për magistrat, profili gjyqtar, në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2021-2022.**

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në nenin 32, pika 4, shkronja “ç” dhe pika 5, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 61, pika 1, në nenin 86, shkronja “ë” dhe në nenin 97, pika 1, shkronja “a”, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në Kreun VI, Seksioni Ç, pika 12, shkronja

“a”, të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

VENDOSI:

1. Skualifikimin e kandidatit z. {...}, për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, profili gjyqtar, në vitin akademik 2021-2022.
2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.
3. Kandidati ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR